REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:076201
Datë: 17.10.2019
Numri i dokumentit: 00585777

C.nr.476/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit K.M nga Ferizaj Rr... të cilin e përfaqëson av.J.B nga Ferizaj, kundër të padituve P.Z ish nga fshati .... Komuna Ferizaj dhe G.J.XH ish nga fshati .... Ferizaj tani me adresë të panjohur të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.B.Q nga Ferizaj për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në seancën e mbajtur më datën 02.10.2019, në prezencë të paditësit dhe të autorizuarit të tij, përfaqësuesit të përkohshëm të padituve mori, kurse me datën 17.10.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
PJESËSHËM

I. **APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit K.M nga Ferizaj Rr..... si e bazuar.

II. **VËRTETOHET** se paditësi K.M është pronar i pjesës ideale të NK.nr... apo në sipër prej 1117m^2 (numri i ri 52-4), e cila ka sipër të përgjithshme prej 4325m^2 e cila pronë sipas gjendjes faktike në pjesën veriore kufizohet me NK.nr...., të përcaktuar në koordinatat nga pika 1 deri te pika 2, në gjatësi prej 27.46m, në pjesën lindore kufizohet me një pjesë të NK.nr.... dhe me NK.nr...., gjendja faktike rrugë nga pika 2 deri te pika 3 në gjatësi prej 37.74m, në anën jugore kufizohet me pjesën e NK.nr..., nga pika 3-4 në gjatësi prej 29.03m, kurse në anën perëndimore me rrugën .... prej pikës 4-5 në gjatësi prej 30.86m dhe prej pikës 5-1 në gjatësi prej 11.44m, ZK Ferizaj.

III. **DETYROHET** i padituri P.Z ish nga fshati .... Komuna Ferizaj tani me adresë të panjohur, që t`ua njeh paditësit të drejtën e pronësisë në paluajshmërinë e përshkruara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij

2019:076202

aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë së tij, do t'i shërbej paditësit, për bartjen e pronësisë të pjesës ideale në emrin e vet, pranë Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Ferizaj.

IV. Secila palë i bart shpenzime e veta, meqenëse paditësi ia ka paguar shpenzimet e procedurës përfaqësuesit të përkohshëm të padituri.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 09.10.2019, ka deklaruar se edhe më tutje mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, thëniet e cekura në seancat e kaluara, duke shtuar se nga provat e administruara, dëgjimit të dëshmitarëve është vërtetuar se paraardhësi i paditësit i ka blerë pronat objekt kontesti nga të padituri, ku pronën e cila gjendet në rrugën .... ku dhe paditësi e ka shtëpinë e ka blerë në vitin 1981, kurse pronën e cila gjendet në fshatin .... Komuna Ferizaj e ka blerë rreth vitit 1984-86, ku prindi i paditësin me rastin e arritjes së marrëveshjes me të padituri e ka përmbushur detyrimin sa i përket çmimit të shitblerjes dhe nga ajo kohë është hyrë në posedim të qet dhe të pa penguar nga askush, i cili fakt është vërtetuar përmes dëgjimit të dëshmitarëve.

Se pas ndarjes nga bashkësia familjare këto prona i kanë takuar paditësit gjykatës ia ka dorëzuar dëshmi vdekjen e të ndjerit-prindit të paditësit dhe deklaratat e trashëgimtarëve, të cilët kanë deklaruar se pronat objekt kontesti i kanë takuar paditësit.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e precizuar të paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paduturve, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 17.10.2019, ka deklaruar se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi, thëniet e cekura në seancat e kaluara, duke shtuar se nga dëgjimi të dëshmitarëve janë sqaruar të gjitha rrethanat ku dhe janë plotësuar kushtet ligjore për të vendosur në lidhje me kërkesëpadisë e paditësit në mënyrë të drejtë dhe meritore nga ana e gjykatës.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës ka theksuar se paditësi e ka përmbushur detyrimin e tij, lartësia e të cilave është llogaritur duke u baza urnë tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: U lexua fatura e tatimit në pronë lëshuar në emër të K.M dt.07.04.2014, certifikata pronësore dt.27.06.2016 për NK ... ZK.Ferizaj, Certifikata pronësoredt.28.06.2016 për NK ... ZK....., njoftimi i lëshuar nga Zyra për Komunitete dhe Kthim nr. 01/19 dt.04.01.2019, e protokolluar në gjykatë më dt.09.01.2019, certifikata e vdekjes për të ndjeri S.M nr. Rend.231 dt.21.06.2018, dëshmi vdekja e të ndjerit S.M e dt.21.06.2018, procesverbali i datës 23.09.2019 në të cilën janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit XH.B dhe R.TH, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F.B për pjesën e ng. Kad. ... dt.01.03.2019 verzioni nr. I, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F.B për pjesën e ng. Kad .... dt.01.03.2019 verzioni nr. II, ekspertiza e ekspertit gjeodezisë F.B përpjesën e ng. kad ... ZK ...., fleta posedues datë 14.03.2019 për NK ... ZK.Ferizaj, shikimi i 9 fotografive të paraqitura në një fletë në format A4, fleta poseduese datë 14.03.2019 për NK ... ZK ....

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se prindi i paditësit S.M me të paditurin P.Z kanë lidhur marrëveshje gojore për shitblerjen e paluajtshmërisë në vitin 1981 të përshkruara sikurse në pikë II të dispozitivit ku sipas kësaj marrëveshje rezulton se i ndjeri paraardhësi i paditësit e ka përmbushur në tërësi çmimin kontraktues në të cilën periudhë i ndjeri S.M ka hyrë në posedim të qet, të ligjshëm dhe me mirëbesim të cilin posedim e ka pasur në mënyrë të pa ndërprerje dhe pa u penguar nga askush, dhe mbi bazën e parashkrimit fitues paditësit si pasardhës të ndjerit S.M e kanë fituar të drejtën e pronësisë.

Trashëgimtarët e rendit të parë të ndjerit S.M dhe atë fëmijët H.M, F.M, R.M dhe E.M siç vërtetohet me anë të dëshmi vdekjes të datës 21.06.2018, me anë të deklaratave trashëgimore të cilat i ka dorëzuar paditësi përmes parashtresës të datës 09.10.2019, kanë hequr dorë nga e drejta e drejta e pronësisë sipas të drejtës së trashëgimisë për pjesën që do tu kishte takuar në emër të prindit të tyre S.M, pasi që të njëjtit kanë theksuar se pronat objekt kontesti pas ndarjes së pasurisë së përbashkët i kanë takuar vëllait të tyre tani paditësit K.M.

Andaj në rastin konkretë gjykata konsideron se pretendimet e paditësit se nuk ka mundur të bëjë bartjen e pronësisë i ndjeri S.M në emër të tij edhe pse i kishte blerë nga i padituri pasi që ka pasur pengesa administrative që ka qenë e ndalur shitblerja e paluajtshmërive në mes qytetarëve të nacionalitetit serb dhe shqiptar gjykata konsideron se nga provat e lart cekura,

dëgjimit të dëshmitarëve, për shkak të rrethanave që kanë ekzistuar në atë periudhë nuk janë lejuar transaksionet pronësore për shkak që të bëhet bartja e pronësisë në procedurë administrative, andaj këto pretendime përputhen në tërësi njëra me tjetrën dhe pretendimet e paditësit në lidhje me arsyet e mos bartjes së pronësisë në emër të tij janë të bazuara dhe përputhet në tërësi me provat e lart cekura.

Gjykata me rastin e daljes në vendin kontestues së bashku me ekspertin e gjeodezisë në ekspertizën e përpiluar dt.01.03.2019, nga eksperti F.B, sqarimeve të dhëna në seancën e datës 23.09.2019, është konstatuar se paditësi si trashëgimtar ligjor i të ndjerit S.M është posedues në mënyrë origjinere të një pjese të NK.nr..... ZK Ferizaj në sipër prej 1117m^2 në të cilën pronë është e ndërtuar shtëpi P+1, është në posedim nga paditësit.

Gjykata përmes dëgjimit të dëshmitarit XH.B ka vërtetur faktin se në kohën kur prindi i tij M.B i cili ka vdekur në vitin 2013, e ka blerë pronën e cila kufizohet me pronën e paditësit dhe sipas këtij dëshmitari duke marr parasysh moshën e tij rreth 45 vite i njëjti ka theksuar se nuk ka qenë prezent kur prindi i paditësit e ka blerë këtë pronë por ka theksuar nga ajo kohë paditësi e ka në posedim dhe shfrytëzim këtë pronë dhe asnjëherë nuk ka pasur ndonjë pengesë rreth shfrytëzimin apo posedimit të kësaj prone nga i padituri apo personat e tretë.

Kurse gjykata përmes deklaratave të dhëna nga H.M, e datës 03.10.2019, e vërtetuar tek noteri me datën 08.10.2019 në Gjenevë, F.M e datës 03.10.2019, e vërtetuar tek noteri me datën 08.10.2019, në Gjenevë, R.M e datës 04.10.2019, e përpiluar dhe vërtetuar tek noteri S.SH me numër LRP.nr.15483/19 dhe E.M e datës 03.10.2019, e përpiluar dhe vërtetuar tek noteri S.SH me numër LRP.nr.15452/19 të cilët sipas dëshmi vdekjes dt.21.06.2018, për të ndjerin S.M rezulton se trashëgimtarët-fëmijët e të ndjerit të njëjtit me anë të deklaratave të dhëna kanë hequr dorë nga e drejta e pronësisë që do ti takonte secilin në këtë pjesë sipas të drejtës së trashëgimisë në emër të vëllait të tyre tani paditësit K.M,

Gjykata duke u bazuar deklaratën e dëshmitarit, paditësit në cilësi të palës, të njëjtat përputhet me konstatimin e gjendjes faktike, dhe me rastin e daljes së gjykatës në vendin ka rezultuar se pretendimet e paditësit se e ka bartur të drejtën e posedimit në mënyrë origjinere pas vdekjes së të ndjerit S.M dhe ndarjes fizike të pronave nga bashkësia familjare ku kjo pronë i ka takuar paditësit që nga viti 1981 e mban me mirëbesim të ligjshëm gjykata duke marr parasysh provat e administruara të njëjtat përputhen në tërësi njëra me tjetrën dhe mbi këtë ua ka falur besimin

dëshmisë së dëshmitarit, paditësit si objektive, pasi që të njëjta përputhen edhe me ekspertizën e gjeodezisë dhe konstatimit të gjendjes faktike.

Andaj gjykata konsideron se pretendimi i paditësit se arsyeja e mos bartjes së kësaj prone ka qenë ndalimi të shitblerjeve në rastet kur shitës kanë qenë qytetar të nacionalitetit serb kurse blerës shqiptar si dhe fakti se i padituri menjëherë është shpërngulur nga fshati ... Komuna Ferizaj është i bazuar pasi që me ligjet që kanë qenë në fuqi nuk është lejuar shitblerja e pronave të qytetarëve të nacionalitetit serb tek ata shqiptar kurse sa i përket arsyetimit të shpërnguljes kjo është vërtetuar nga flet-kthesa e ardhur 01.06.2018, ku është konstatuar se i padituri është shpërngulur nga ky fshat sa i përket ligjshmërisë dhe mirëbesimin paditësit e kanë argumentuar me anë të dëshmitarit.

Gjykata meqenëse nga provat e administruara është konstatua se pronën e ka blerë paraardhësi i paditësi, kurse nga deklaratat e trashëgimtarëve tjerë ka rezultuar se pas ndarjes së pasurisë ë përbashkët kjo pronë i ka takuar paditësit gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 12 të Ligjit për Trashëgimi e ka përcaktuar çart radhë e trashëgimisë, ku thuhet "Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij", andaj nga dëshmi vdekja ka rezultuar se i ndjeri pas vetës ka lënë trashëgimtarët ligjor paditësit dhe fëmijët tjerë të cilët me anë të deklaratave trashëgimore të lart cekura kanë hequr dorë në favor të paditësit

Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se nga provat të cilat janë administruara paditësit, e kanë vërtetuar ligjshmërinë e posedimit dhe mirëbesimin dhe janë krijuar kushtet ligjore që në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ t'iu njihet e drejta e pronësisë në pronën e përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit.

Gjykata sa i përket kërkesëpadisë së paditësit në lidhje me pjesën e NK.nr.... në sipër prej 8254m^2 ZK ...., nuk ka vendosur për faktin se nga deklarata e paditësit të dhënë në cilësi të palës në seancën e datës 02.10.2019, rezulton se prindi i paditësit këtë pronë nuk e ka blerë drejtëpërdrejtë nga pronari juridike tani i padituri XH.G, por e ka blerë nga personi me emrin S..., e i cili nuk ka qenë palë në procedurë, andaj meqenëse nuk është vërtetuar ligjshmëria e posedimit, barta e saj nga i padituri tek personi me emrin S.... gjykata, në lidhje me këtë nuk ka vendosur, kurse sa i përket kërkesë për pjesën e NK.nr...., është shqyrtuar mjaftueshëm dhe janë pjekur kushtet për të vendosur në lidhje me këtë kërkesë me vendim meritor kuptim neni 147 të LPK-së.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës meqenëse paditësi ia ka paguar përfaqësuesit të përkohshëm shpenzimet e procedurës dhe i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë ka vendosur kuptim nenit 450 të LPK-së që secili ti bart shpenzimet e veta.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.476/16 me datë 17.10.2019

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.